



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1215/7 prot.

Datë 21.07.2022

V E N D I M

Nr. 681/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguri	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-27596-05-05-2022 me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi*”, me fond limit 16,996,283 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 30.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2AT” SHPK në procedurën në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk
Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a.
Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, rruga “Petraq Popa”,
Elbasan

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “2 AT” SHPK
Korçë- Dishnicë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.05.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-27596-05-05-2022 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi”, me fond limit 16,996,283 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 30.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.

II.2. Në datën 30.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 31.05.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

“Albania Distribution Chemicals” shpk	15.341.400 lekë	I skualifikuar
“2 AT”shpk	16.761.900 lekë	I kualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” shpk rezulton i skualifikuar me arsyetimin:

OE ka paraqitur certifikaten e analizës nga Instituti i Shendetit Publik, për analizë toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi) të marre brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. OE nuk ka paraqitur analizat e plota sipas kërkesës në dokumentat standarte të tenderit. Mungojnë vlerat për Densiteti, Substancat Toksike, Arsenik, Merkur, Antimon dhe Selen. OE ka deklaruar në formularin e vetedeklarimit që ka një kontratë qeraje për mjetin TR3368N, mjet i pajisur me Leje Transporti për lende të rrezikshme, dokumentat e paraqitura të verifikuara në tabelene e ADR janë të Class 3 pra për lende të djegshme dhe jo lende korrozive dhe në certifikate është cilesuar kategoria FL.

II.4. Në datën 06.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 08.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2022/2264 dhe me nr. 1215/2022 protokollin e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij si dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së të operatorit ekonomik “2 AT”shpk.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1215/2 prot., datë 09.06.2022 duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së tij si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” shpk në ankesën me nr. 1215/2022 prot., datë 08.06.2022, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “2 AT”shpk.

II.6.1 Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” si më poshtë vijon:

[...]2.3.3 Ofertuesi duhet te vertetoje se produkti qe do te furnizohet eshte i pershtatshem ne trajtimin e ujit te destinuar per konsum njerezor, konform normave europiane: EN 901:2013. Per kete qellim duhet te paraqitet si dokument kualifikues dokumentacion nga prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi te akredituara nga institucionet perkatese, qe deshmon qe produkti i prodhuar ploteson Standartin European te kerkuar EN 901:2013” ose ekuivalente me te dokument qe ploteson standartin shqiptar S SH/EN 901:2013 mbi parametrat e Hipokloritit të Natriumit.

Ofertuesi duhet te paraqesi certifikaten e analizës nga Instituti i Shendetit Publik, ose deshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, per analize toksikologjike per NaOCl. (hipoklorit natriumi) te marre brenda tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

Se pari: per sa me siper duam t’iu bejme me dije se operatori jone ekonomik nuk ka depozituar prane AK asnje flete analize toksikologjike te bere prane ISHP, pasi prej kohesh ky sherbim nuk ofrohet ne kete institucion. Per teper ne analizat toksikologjike elementet e analizuar kane qene gjithmone: plumbi (Pb), Kadiumi (Cd), Kromi (Cr), nderkohe elemente si Zhiva (Hg), Arsenik (As), Antimoni (Sb) dhe Seleni (Se) nuk jane analizuar asnjehere ne te gjithë vitet e funksionimit te ISHP per shkak te mungeses se bazes materiale ne labororet qe funksionojne ne Republiken e Shqiperise. Per me teper nese do ti permbahemi standartin shqiptar S SH/EN 901:2013 mbi parametrat e Hipokloritit të Natriumit, duhet te perfshihen ne analize edhe elemente te tjere per analize si Sodium Bromate, por labororet shqiptare nuk jane te pajisur me bazen materiale per te bere te plote gjithë elementet toksikologjike per analizen toksikologjike, per kete arsye asnje operator ekonomik nuk mban pergjegjesi per analizat e paplote qe dorezon, pasi keto pergjegjesi i takojne vetem Ministrise se Shendetesise (MSH) dhe labororeve qe varen prej saj dhe jo OE. OE ofron ate qe labororet e certifikuar shqiptare (certifikuar nga MSH) mund te analizojne dhe qe vete Ministria e Shendetesise e pranon kete analize toksikologjike (me mungesat e pretenduara) kur autorizon Lejen e Importit per OE per te importuar kete mall objekt prokurimi. Per vite me rradhe ne keto procedura me te njejtin mall objekt prokurimi te zhvilluar nga te gjithë Autoritetet Kontraktore eshte pranuar analiza toksikologjike e ISHP me mungese te analizimit e elementeve te pretenduar nga AK., pasi eshte marre e mireqene pamundesia per te analizuar te gjithë elementet toksikologjike. Ne te gjitha procedurat e zhvilluar nga Autoriteti juaj kontraktor madje edhe ne proceduren e fundit (viti 2020) , ju keni pranuar analizen e kryer nga ISHP, ku mungonin elementet te cilet i kerkonin ne kete procedure. Kjo sepse ju keni favorizuar si gjithmone operatorin ekonomik 2 AT sh.p.k qe fiton cdo procedure me te njejtin mall objekt prokurimi hedhur nga AK juaj. Mbeshtetur nga sa mesiper arsyetimi i AK nuk perben kusht per skualifikim. Operatori jone ekonomik i ndodhur perballe faktit qe ISHP nuk ofron sherbimin e analizave toksikologjike ka depozituar prane AK analizen toksikologjike nga nje laborator i certifikuar, ashtu sikurse eshte percaktuar ne DST, brenda standartit te percaktuar dhe njohur nga Ministria e Shendetesise. Per kete arsye pretendimi i ngritur nga AK per skualifikim nuk qendron, pasi ne nuk kemi paraqitur analizen e ISHP por nga nje laborator i certifikuar.

2.3.6. *Çertifikate/Leje/Liçense e leshuar nga autoriteti kompetent per "Transport lende te rrezikshme" (ADR) e shoqeruar detyrimisht me Leje te Qarkullimit te automjetit special ne pronesi ose me Kontrate Qiraje (ose huaperdorje) me akt-noterial, te vlefshme per gjate gjithe procedures se prokurimit, per automjetin special, qe do te sherbeje per transportin e kimikatit Hipoklorit natriumi.*

Se dyti: per sa i takon pretendimit se : iOE ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit qe ka nje kontrate qeraje per mjetin TR3368N, mjet i pajisur me Leje Transporti per lende te rrezikshme, dokumentat e paraqitura te verifikuara ne tabelen e ADR jane te Class 3 pra per lende te djegshme dhe jo lende korrozive dhe ne certifikate eshte cilesuar kategoria FL"? ju bejme me dije se sikurse kemi cituar edhe me siper ne DST, AK ne asnje moment nuk ka parashtuar kategori ADR-je sikurse pretendon ne arsyetimin e skulifikimit. Ne DST eshte shprehur qarte se kerkohet vetem Certifikate/ Leje/ License per Transport lende te rrezikshme (ADR), pa specifikuar asnje klase apo kategori, ndodhur perballe ketij fakti ne kete faze vleresimi AK nuk mund te kerkoje asgje me shume nga sa ka kerkuar ne DST. Nese do ta vleresonte si te rendesishme dhe kusht per skualifikim duhet ta percaktonte qarte ne DST dhe jo ne kete faze vleresimi. Ne kontraten e qerases paraqitur nga ana jone eshte percaktuar qarte qe mjete eshte pajisur me leje per Transporti e lendeve te rrezikshme (ADR) ashtu sikurse kerkohet ne DST. Per me teper mjete i paraqitur ne kete procedure prokurimi eshte perdorur dhe perdoret nga ana jone per transportin e mallit objekt prokurimi Hipoklorit Natriumi, pa asnje pretendim nga Autoritet e tjera kontraktore qe ne si OE kemi lidhur kontrate per procedurat e shpallur fitues.

Se treti: Ne permbushje te kriterit 2.3.3 permendur me siper per depozytimin e analizes toksikologjike te ISHP ose laboratoreve te certifikuar, ne dyshojme se OE "2AT" shpk ka paraqitur Raport Analizen nr. 368 realizuar nga Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Tirane. Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Tirane nuk kryen analize toksikologjike (metalet e renda: Plumb, Nikel, Kadium, Krom) por vetem vleresim fiziko-kimik (ngjyre, arome, gjendje, titulli), kete e vertetojme edhe me shkresen me nr. 102/1 Prot, date 18/01/2022, ku Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Tirane, eshte shprehur qarte nder te tjera se ne laboratorin e tyre nuk ka kapacitete te instaluara per ekzaminimin toksikologjik (metalet e renda). (gjeni bashkangjitur) Ju lutemi te beni verifikimin nese OE "2 AT" shpk ka paraqitur analizen toksikologjike (metale te renda) sikurse eshte kerkuar ne DST apo ka paraqitur analizen fiziko-kimike te Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Tirane, e cila nuk kerkohet ne DST. Nese vertetohet sa me siper OE "2AT" sh.p.k nuk ploteson kriterin 2.3.3 cka behet kusht per skualifikine tij nga kjo procedure.

Te nderuar anetare te KPP ne jemi te vetedijshem qe ankesa jone nga AK nuk do te pranohet pasi nder vite ky AK ka favorizuar dhe shpallur fitues te njejtin Operator Ekonomik, "2 AT" shpk, pa gare pa konkurrence, per shkak te kriterëve abusive te vendosuar prej tij, prandaj kerkojme nga ana juaj te pranohet ankesa jone dhe ne si operatore ekonomike te mos te diskriminohemi dhe te ndihemi te barabarte ne proceduren e prokurimit ashtu sikurse LPP e ka te percaktuar qarte ne nenin 2.[...]

II.7. Me shkresën nr. 2793prot., datë 14.06.2022 me objekt: “Kthim përgjigje formularit të ankesës dt. 08.06.2022 të shoqërisë “Albania Distribution Chemicals” shpk”, protokolluar me tonën me nr. 1215/4 prot., datë 16.06.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi nr. 1819/6prot.datë 14.06.2022, i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit.

II.8. Me shkresën datë 20.06.2022 me objekt: “Argumenta për ankesën A/2022/2264”, protokolluar me tonën me nr. 1215/5 prot., datë 20.06.2022, operatori ekonomik ankimes “Albania Distribution Chemicals” shpk ka paraqitur argumentat e tij në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor në lidhje me ankesën për procedurën objekt prokurimi.

II.9. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se me anë të formularit të paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar, protokolluar me tonën nr. 1215/3prot datë 13.06.2022 operatori ekonomik “2 AT” SHPK pjesmarrës në procedurën eprokurimit ka paraqitur argumentat e tij, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se “[...]OE ka paraqitur certifikaten e analizes nga Instituti i Shendetit Publik, per analize toksikologjike per NaOCl. (hipoklorit natriumi) te marre brenda tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit. OE nuk ka paraqitur analizat e plota sipas kerkeses ne dokumentat standarte te tenderit. Mungojne vlerat per Densiteti, Substancat Toksike, Arsenik, Merkur, Antimon dhe Selen.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret si më poshtë:

2.3.3 Ofertuesi duhet te vertetoje se produkti qe do te furnizohet eshte i pershtatshem ne trajtimin e ujit te destinuar per konsum njerezor, konform normave europiane: EN 901:2013. Per kete qellim duhet te paraqitet si dokument kualifikues dokumentacion nga prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi te akredituara nga institucionet perkatese, qe deshmon qe produkti i prodhuar ploteson Standartin European te kerkuar EN 901:2013” ose ekuivalente me te dokument qe ploteson standartin shqiptar S SH/EN 901:2013 mbi parametrat e Hipokloritit të Natriumit.

Ofertuesi duhet te paraqesi certifikaten e analizës nga Instituti i Shendetit Publik, ose deshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, per analize toksikologjike per NaOCl. (hipoklorit natriumi) te marre brenda tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

III.1.2. Në Shtojcën 5, “Specifikimet teknike”, , autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret si më poshtë:

[...]

Specifikimi i Materialeve:

Hipoklorit Natriumi (NaOCl)			
Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat
1	Gjendja	-	Lëng i qartë
2	Ngjyra	-	E verdhë
3	Destiteti 20°C	gr / ml	1.13 – 1.24
4	Titulli Cl ₂	% (m / m)	13 – 16
5	Substancat toksike	mg / kg	Limitet në mg / kg të klorit të lirë
6	Arsenik (As)	mg / kg	max 1
7	Kadmium (Cd)	mg / kg	max 2.5
8	Krom (Cr)	mg / kg	max 2.5
9	Mërkur (Hg)	mg / kg	max 3.5
10	Nikel (Ni)	mg / kg	max 2.5
11	Plumb (Pb)	mg / kg	max 15
12	Antimon (Sb)	mg / kg	max 20
13	Selen (Se)	mg / kg	max 20

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Certifikatë analizë nr. 7.110_22 datë 27.04.2022 lëshuar nga Tenuis Laboratories
 Akti i autorizimit të produktit biocid
 Autorizim Allchital srl
 Autorizim Allchital srl datë 10.01.2022
 Certifikata e orgjinës

Skeda e te dhënave teknike

III.1.4. Me shkresën nr. 1186/6 prot., datë 24.06.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion Drejtorisë së Përgjithsme të Akreditimit, si më poshtë vijon: “ [...]Aktualisht Komisioni është duke shqyrtuar një ankesë. Në ankesën objekt ankimi konsatojmë se nga operatori ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, është paraqitur listë analiza toksikologjike lëshuar nga Tenuis Laboratories shpk. Lidhur me këtë fakt, Komisioni kërkon nga ana juaj si institucion kompetent, një informacion nëse Tenuis Laboratories SHPK është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin Hipoklorit Natriumi.”

Sa më sipër, në zbatim të nenit 24 e vijues të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 24, pika 2 të Ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe Vendimit Nr. 867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj informacionin për sa më sipër.[...]”

III.1.5. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1186/6/11 prot., datë 24.06.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, me shkresën nr. 259/1 prot., datë 6.07.2022, protokolluar me tonën 1186/8prot datë 13.07.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon KPP-në se: “ [...] Në përgjigje të shkresës nr. 1186/6prot datë 24.06.2022 me lëndë kërkesë për informacion “ protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 259prot datë 29.06.2022 ju informojmë se Tenuis Laboratories shp , është i akredituar për matricat e analizave të ndryshme toksikologjike që lidhen me Hipoklorit Natriumin , por nuk është e certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin e mirfilltë Hipoklorit Natriumi.[...]”

III.1.6. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.7. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.1.8. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për plotësimin e kriterit të veçantë të kualifikimit konkretisht dokumentit “Certifikatë analizë nr. 7.110_22 datë 27.04.2022” lëshuar nga Tenuis Laboratories, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, duke kërkuar informacion nëse Tenuis Laboratories SHPK është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin Hipoklorit Natriumi. KPP konstatoi, se referuar korespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, kjo e fundit informon, se Tenuis Laboratories shpk, është i akredituar për matricat e analizave të ndryshme toksikologjike që lidhen me Hipoklorit Natriumin, por nuk është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin e mirfilltë Hipoklorit Natriumi. Sa më sipër, në mbështetje të korespondencës me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimeve, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” shpk me dokumentacionin e paraqitur në rastin konkret nuk provon, se malli/produkti me të cilin do të furnizojë autoritetin kontraktor nuk është i pajisur me dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analizë

toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi), duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.3. të kriterëve të veçanta për kualifikim ku përcaktohet shprehimisht, se operatori ekonomik për mallin/produktin objekt prokurimi duhet të disponojë dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre. Pra, sa më sipër, për sa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentet e tenderit, që operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë certifikatën e analizës nga Instituti i Shendetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për mallin/produktin që prokurohet, dokumenti certifikatë analizë toksikologjike e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë procedurë prokurimi, nuk është i vlefshëm, pasi Tenuis Laboratories SHPK i cili e ka lëshuar këtë certifikatë analizë nuk është i akredituar për analizën toksikologjike të mirëfilltë të hipoklorit natriumi ashtu siç është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues "Albania Distribution Chemicals" shpk, mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë

që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” shpk, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “2AT” SHPK, KPP sjell në vëmendje nenin 94 pika 1 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik Albania Distribution Chemicals” shpk mbi ofertën e operatorit ekonomik “2AT” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik., nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-27596-05-05-2022 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi”, me fond limit 16,996,283 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 30.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri